



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.539/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimiq dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër komisionerëve në QV 1105B/04R për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë si e parregullt ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV.

ARSYETIMI

Më datë 13.12.2010 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, në të cilën pretendohet se me datë 12.12.2010 në shkollën fillore Skënderbeu në Vaganicë të Mitrovicës në vendvotimin me nr.1102B/04R në ora 16:20, një votues haptas është vërejtur se ka votuar dy herë, kurse komisionerët nuk e kanë penguar këtë keqpërdorim. Ndërsa sipas parashtruesit të ankesës në ora 15 30 një votues ka votuar pa letërnjoftim, e këtë parregullsi në heshtje e kanë lejuar komisionerët, si dhe është vërejtur joseriozitet në punën e komisionerëve duke lëshuar qendrën e votimit shpesh herë.

Me rëndësi është fakti, se parashtruesi i ankesës nuk e ka vërtetuar përmbajtjen e pretendimeve për arsye se formulari i ankesës se pranuar prej PZAP më datë 13.12.2010 nuk ka qene i firmosur prej personit të autorizuar të Lëvizjes Vetëvendosje .

Ne kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe nenit 3.6, pika (d) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP parashihet si vijon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

3.6 Te gjitha ankesat duhet te kenë se paku informacionet vijuese:

(d) vërtetimin nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës.

Nga shkresat e lendes PZAP-i konstaton se ankesa është e parregullt për faktin se formulari i ankesës nuk përmbush kushtet e lartpërmendura, **parashtruesi i ankesës nuk e ka nënshkruar ankesën e paraqitur, për këtë arsye dhe duke u bazuar në** në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 539/2010 më datën 15.12.2010

Kryesuesi i Panelit

Ferit Osmani

